



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2020:110717

Datë: 24.01.2024

Numri i dokumentit: 05232112

**AA.nr.216/2023**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative,** në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Delushe Halimi dhe Hajriz Hoti anëtarë, në konfliktin administrativ të paditësit B... A... nga F... të cilin sipas autorizimit e përfaqësojn I... A... dhe R... F..., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, për shkak të anulimit të Njoftimit me numër protokoli 4231-20 të datës 30.09.2020, me kërkesën për nxjerrjen e aktit administrativ dhe anulimin e Kushteve Ndërtimore si dhe Vendimit për leje ndërtimore me numër të vrojtimit 04-351/02-0030187/20 të datës 21.05.2020, duke vendosur lidhur me ankesën, e të paditurës, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1497/2020, të datës 23.02.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 11.01.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

Miratohet si e bazuar ankesa, e të paditurës Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1497/2020, i datës 23.02.2023, anulohet dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1497/2020, i datës 23.02.2023, në pikën I të dispozitivit, është aprovuar si e bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit B... A... nga F... Në pikën II të dispozitivit anulohet Njoftimi me numër protokoli 4231-20 i datës 30.09.2020 i të paditurës, ANULOHET Vendimi për ricaktimin e kushteve ndërtimore nr.04-351/01-0027618 i datës 30.03.2020 dhe

ANULOHET Vendimi për Leje ndërtimore me nr.04-351/02-0030187/20 i datës 21.05.2020 të nxjerrë nga Drejtoria për Urbanizëm e Komunës së Ferizajt. Në pikën III të dispozitivit DETYROHET e paditura Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe organi i shkallës së parë Komuna e Ferizajt për zbatimin e këtij Vendimi, dhe atë në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm. Nën pikën IV të dispozitivit është vendosur që në lidhje me këtë Aktgjykim, njoftohet Zyrtari Kryesor Administrativ i të paditurës dhe i njëjti detyrohet të njoftoj edhe organin administrativ të shkallës së parë Komunën e Ferizajt. Në pikën V të dispozitivit është vendosur që ky Aktgjykim i zëvendëson aktet e anuluar dhe ka karakter detyrues. Në pikën VI të dispozitivit është vendosur që secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi ka ushtruar ankesë e paditura duke dorëzuar ankesë në gjykatë me dt.15.03.2023 dhe 18.07.2023, përmes përfaqësueses së saj, Ministria e Drejtësisë-Avokatura Shtetërore, për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Duke pohuar se gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së aktvendimit të ankimuar nuk i ka vlerësuar drejtë provat e paraqitura nga ana e të paditurës, pasi që arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar e bazon thjeshtë në provat dhe të dhënat të cilat i arsyeton përfaqësuesi i paditësit, ndërsa nuk i merr për bazë të dhënat të cilat i arsyeton dhe prezanton përfaqësuesja e të paditurës, të cilat i refuzon pa ndonjë arsyetim të mirëfilltë. Pastaj se, gjykata e shkallës së parë gjatë shqyrtimit të çështjes juridike nuk i ka konstatuar fare faktet e rëndësishme për zgjedjen e çështjes. Ngase në këtë rast nuk ka bere vlersimin e duhur të fakteve relevante për zgjedhjen e çështjes. Në këtë drejtimgabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale. Me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, ashtu që të refuzohet padia në tersi si e pabazuar, dhe të mbetet në fuqi vendimi i të paditurës.

E autorizuar e paditësit Avokatia ICL Law me avokat M... B... dhe avokat R... F..., avokat nga Prishtina, në përgjigje në ankesë dhe plotësimin e përgjigjes në ankesë të dt.24.05.2023 pretendimet ankimore të paditurës i konteston si të pa bazuara, me propozim që e njëjta të refuzohet në tersi si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore në ankese të paditurës, përgjigjen në ankesë, plotësimin e përgjigjes në ankesë të dt.24.05.2023 dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 194 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për konfliktin administrativ (LKA), ka gjetur se:

### **Ankesa është e bazuar.**

Nga shkresat e lëndës, rezulton se gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të padisë së paditësit për anulimin e Njoftimit me numër protokoli 4231-20 të datës 30.09.2020, me kërkesën për nxjerrjen e aktit administrativ dhe anulimin e Kushteve Ndërtimore si dhe Vendimit për leje ndërtimore me numër të vrojtimit 04-351/02-0030187/20 të datës 21.05.2020, të njëjtën e ka aprovuar si të bazuar. Me arsyetim se nga shkresat e lëndës rezulton

se paditësi me kërkesën përkatësisht ankesën me numër protokollit 2265-6/20 të datës 09.07.2020 kishte kërkuar nga e paditura që të marr vendim me të cilin pezullohet vendimi për leje të ndertimit, numri i vrojtimit të lejes 04-351/-2-0030187/20 të datës 21.05.2020 deri në marrjen e vendimit lidhur me ankesën si dhe të aprohet si e bazuar ankesa dhe të anulohet vendimit me numër të vrojtimit të lejes 04-351/-2-0030187/20 të datës 21.05.2020, por që e paditura nuk ka marrë vendim për ankesën e paditësit, edhe pas shkresës së datës 04.08.2020 për dorëzimin e provave shtesë nga ana e paditësit dhe edhe pas urgjencës së datës 14.08.2020 për zgjidhjen e ankesës. Gjykata e shkallës së parë poashtu gjeti se në asnjërin nga komunikimet në mes të paditësit dhe të paditurës, e njëjta nuk ka arritur që ndaj kërkesave, njoftimeve apo ankesave të paditësit, të marr Vendim, meqenëse marrja e vendimit sipas ankesës së paraqitur dhe dorëzimi i tij palës në procedurë, është obligim i organit të paditur konform nenit 26, 27 dhe 132 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Gjykata e shkallës së parë gjeti poashtu, se me mos trajtimin e ankesës së paditësit, duke vepruar sipas kompetencës funksionale dhe ligjore që do të duhej të identifikohesh menjëherë dhe pa vonesa si dhe me pamundësimin e dëgjimit të palës paditëse, ka bërë shkelje të rëndë të nenit 4-Parimi i ligjshmërisë, nenit 8-Parimi i pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme si dhe nenit 95-E drejta e dëgjimit, të Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative. Mbi këtë gjendje të fakteve, gjykata konstatoi se në këtë çështje administrative-juridike në çdo fazë të procedurës administrative të zhvilluara në të dy organet, është shkelur ligji në dëm të paditësit, dhe organi i paditur ka dështuar të marr Vendim të drejtë e të bazuar në Ligj në lidhje me ankesën e paditësit, duke mos zbatuar asnjë vendim të Gjykatës të dhënë paraprakisht në këtë çështje të konfliktit administrativ.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes dhe pas ekzaminimit të aktgjykimit të ankimuar, dhe shkresave të tjera të lëndës, e duke i pasur parasysh edhe pretendimet ankimore të paditurës, gjen se tani për tani nuk mund ta pranojë si të drejtë dhe të ligjshëm një qëndrim të tillë të gjykatës së shkallës së parë, për shkak se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika i) dhe n), neni 183 dhe 184 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së. Sepse, arsyet në të cilat bazohet për faktet vendimtare nuk janë të qëndrueshme, kjo për faktin se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkeljet e dispozitave ligjore në fuqi, për çka në mënyrë të bazuar theksohet në ankesë. Andaj, kolegji i kësaj gjykate duke pasur parasysh pretendimet ankimore në ankesë dhe duke pasur parasysh se me këtë aktgjykim është vendosur të anulohet përveç Njoftimit me numër protokollit 4231-20 i datës 30.09.2020 të paditurës, edhe Vendimi për ricaktimin e kushteve ndërtimore nr.04-351/01-0027618 i datës 30.03.2020 dhe Vendimi për Leje ndërtimore me nr.04-351/02-0030187/20 i datës 21.05.2020 të nxjerrë nga Drejtoria për Urbanizëm e Komunës së Ferizajt që në këtë rast mund të paraqiten si pale të interesuar për ndërhyrje në procedurë, pasi që kanë interes juridik me qenë palë e interesuar, vlerëson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë, ngase përmban shkelje thelbësore të dispozitave të nenit 21, 37, 39 dhe 55 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Meqe me dispozitën e nenit 21 të LKA-së, përcaktohet se *“Pozitën e palës në konfliktin administrativ e ka edhe personi të cilit anulimi i aktit administrativ të kontestuar do ti sillte dëm të drejtpërdrejtë ose të tërthortë”*, që do të thotë se në rastin konkret ky presupozim është plotësuar. Ngase palet e interesuar, nuk kanë qenë të përfshira, dhe nuk

i'u ka dhënë mundësia që të jenë palë për shqyrtimin e çështjes në gjykatë, të cilat bëjnë shkelje esenciale të dispozitave të lartcekura që ky aktgjykim të mos mund të ekzaminohet, dhe si i tillë është jo i plotë për faktin se nuk janë dhënë arsye përkitazi me faktet vendimtare, ngase në këtë çështje juridike nuk ka prova se janë përfshirë palët e interesuara.

Me dispozitën e nenit 37 par. 1 të LKA-së përcaktohet se *“Nëse gjykata nuk e hedh poshtë padinë, sipas paragrafit 2 të nenit 33, apo në bazë të nenit 34 të këtij ligji ose nuk e anulon aktin administrativ sipas nenit 35 të këtij ligji, gjykata do t’ia dërgoj nga një kopje të padisë dhe të dokumenteve të bashkangjitura në përgjigje palës së paditur dhe personave të interesuar”*. Kurse me dispozitën e nenit 39 par. 1 të LKA-së përcaktohet se *“Gjyqtari mbikëqyrës cakton ditën e shqyrtimit, dhe në shqyrtim do të ftoj palët dhe personat e interesuar”*. Ndërsa me nenin 55 par.1 pika 1.6 të LKA-së, përcaktohet se *“Pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi, që ka marrë formë të prerë kur: personit të interesuar nuk iu është dhënë mundësia për të marrë pjesë në konfliktin administrativ”*. Prandaj, në rastin konkret nga shkresat e lëndës rrjedh se *personave të interesuar, duhet dhënë mundësia për të marrë pjesë në konfliktin administrativ*.

Nga shkresat e lëndës dhe arsyetimi i aktgjykimit të ankimuar rezulton se gjykata e shkallës së parë nuk i ka njoftuar *personat e interesuar* për shqyrtimin e kontestit edhe pse shihet qartë interesi i tyre për pjesëmarrje në kontest, pasi që të njëjtit kanë të drejtë në pjesëmarrje për të mbrojtur interesat të cilat i janë përcaktuar me ligj. Ngase pala e interesuar në konfliktin administrativ është palë, që do të thotë se gjykata e shkallës së parë është e obliguar që t’ia dërgoj padinë në përgjigje, kurse ajo ka të drejtë që të propozoj nxjerrjen e provave dhe të ndërmarr veprime të tjera në kontest, ka të drejtë që të marr pjesë në shqyrtimin verbal, të deklarohet për të gjitha faktet dhe çështjet juridike, si dhe duhet ti dërgohet vendimi gjyqësor. Po ashtu, pala e interesuar ka të drejtë në shfrytëzimin e të gjitha mjeteve juridike në konfliktin administrativ. Ajo është e autorizuar, si dhe paditësi që në mënyrë të pavarur të ndërmarr të gjitha veprimet në kontest nën supozimin se është plotësisht e aftë për ndërmarrjen e veprimeve në kufijtë e aftësive të veprimit. Në emër të tij, veprime në kontest mund të ndërmarr edhe personi i autorizuar për përfaqësime i palës së interesuar. Prandaj, nga shkresat e lëndës del se gjykata e shkallës së parë nuk i ka njohur këto të drejta palës së interesuar, përkatësisht *personave të interesuar* sepse nuk ka asnjë provë për këtë, dhe as arsyetim se për çfarë arsye nuk i’u kanë njohur këto të drejta dhe dhënë mundësia që të jenë palë në procedurë, andaj, edhe gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht.

Si pasojë e këtyre të metave të cekura me lartë, dhe shkeljeve thelbësore të procedurës rezulton se edhe gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë jo të plotë, dhe në një gjendje të tillë faktike e drejta materiale nuk është zbatuar drejtë.

Për këto arsye, në rivendosje gjykata e shkallës së parë duhet të mënjanoj të metat e lartcekura, duke i’u lejuar dhe njohur të drejtat palës së interesuar - *personave të interesuar* si palë në procedurë për shqyrtimin e çështjes në gjykatë që ti paraqesin provat e veta për vërtetimin e pretendimeve të tyre. Pra, të bëjë vërtetimin e të gjitha fakteve të nevojshme dhe rrethanave që janë me ndikim për zgjidhjen e kontestit. Andaj, gjykata e shkallës së parë duhet

ti mënjanoj të metat e vërejtura sipas këtij aktvendimi, dhe pas mënjanimi të tyre ka mundësi të bie vendim të drejtë dhe të ligjshëm në kuptim të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, si dhe nenit 195 par.1 pika c) të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E APELT E KOSOVËS NË PRISHTINË**

AA.nr.216/2023, me datë 11.01.2024

**Kryetari i kolegjit**  
Ramiz Kuqi